



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot. 220-220/1-220/2-220/3-220/4

Tiranë më 02 Prill 2019

Drejtuar: 220/5-220/6-220/7-220/8-220/9
Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Z. Gent Ibrahimi
Z. Kostaq Beluri
Z. Gentian Osmanaj
Z. Bujar Sheshi
Z. Besnik Cani
Z. Arben Dollapaj
Z. Tartar Bazaj
Znj. Nurihan Seiti Metaj
Z. Sander Beci
Z. Alfred Balla

Nga: Znj. Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: *Letër e hapur lidhur me karakterin e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP)*

Kthim përgjigje shkresës së KLP-së me nr. 262/1 prot dhe dt. 28.03.2019

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

Me anë të shkresës Tuaj me nr. prot 262/1, dt. 28.03.2019, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është informuar ndër të tjerash, se bazuar në nenet 164, 165, 166 dhe 167 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ndjek dhe zbaton rregullat për thirrjen e mbledhjeve, rendin e ditës, kuorumin, vendimmarrjen si dhe dokumentimin e mbledhjes plenare. Këto nene, referuar citimeve në këtë shkresë, nuk përmbajnë asnjë dispozitë detyruese për Këshillin për të organizuar mbledhje të hapura. Pavarësisht kësaj, Këshilli ka marrë parasysh kërkesat e organizatave të ndryshme vendase dhe të huaja për të dërguar përfaqësues të tyre, për të marrë pjesë dhe për të monitoruar mbledhjet e Këshillit. Gjithashtu në këtë shkresë, Këshilli referon se ka realizuar gjerësisht transparencën me median dhe publikun, me anë të faqes së tij të internetit. Megjithatë, sa i takon mbledhjeve plenare, Këshilli referon se është në diskrecion të Këshillit të vlerësojë mënyrën e realizimit të tyre.

Sa më sipër, KShH vlerëson angazhimin e KLP-së në përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". KShH si një organizatë e cila ka dhënë kontributin e saj modest në hartimin e legjislacionit të ri të sistemit të drejtësisë, vëren se ky legjislacion është projektuar mbi parime të rëndësishme që synojnë rritjen e besimit të publikut në sistemin e ri të drejtësisë. Një nga këto parime është edhe transparenca. Konkretisht, në nenin 2 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet se "Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efçencës". Gjithashtu, KShH vëren se zbatimi i



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

legjislaconit të ri të sistemit të drejtësisë duhet të shënojë progres dhe jo regres në raport me funksionimin e institucioneve të mëparshme të qeverisjes të drejtësisë.

Sa i takon mënyrës së realizimit të mbledhjeve plenare të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, KED), vërejmë se përjashtimisht, ligjvënësi ka parashikuar mbledhje të mbyllura vetëm për një nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED), përkatësisht në nenin 231, pika 1 të tij. Nëse ligjvënësi do të kishte patur si qëllim që edhe mbledhjet plenare të të dy Këshillave (atij të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë) të ishin të mbyllura, kjo do të ishte parashikuar në të njëjtën mënyrë edhe për këto organe. Përkundrazi, në asnjë dispozitë të ligjit nr.115/2016 nuk parashikohet zhvillimi i mbledhjeve të KLP-së me dyer të mbyllura, me përjashtim të nenit 191 të tij ku parashikohet shprehimisht zhvillimi i seancës plenare me dyer të mbullura për rishikimin e akteve individuale.

KShH vëren se praktika e zhvillimit të mbledhjeve me dyer të mbyllura nuk gjen mbështetje dhe nuk justifikohet në ligjin nr.115/2016, me përjashtim kur jemi para rasteve të parashikuara në nenin 191 të këtij ligji. Gjithashtu, KShH tërheq vëmendjen për këtë fakt, duke marrë shkas edhe nga mbledhja e datës 25 Mars 2019, ku KShH u njoftua nëpërmjet pikës së kontaktit të KLP-së mbi realizimin e një mbledhje *ad hoc*, pasi efektivisht kjo mbledhje kishte filluar. Njoftimi paraprak dhe axhenda e mbledhjes plenare nuk rezultojnë që të jetë publikuar paraprakisht në faqen zyrtare të KLP-së, ndërkohë që njoftimi pas fillimit të mbledhjes e bëri të pamundur monitorimin e saj nga ana e vëzhguesve të autorizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

KShH sugjeron në të ardhmen shmangien e praktikave të tilla, me qëllim realizimin në kohë të transparencës për veprimtarinë dhe vendimmarrjet e KLP-së, para, gjatë dhe pas realizimit të mbledhjes plenare të saj. Transparenca e KLP-së ndaj publikut është e rëndësishme sa i takon besimit të publikut në rezultatet dhe integritetin e veprimtarisë së këtij organi të rëndësishëm kushtetues të qeverisjes së prokurorëve.

Sa më sipër, dëshirojmë të evidentojmë dhe ritheksojmë se KShH po monitoron në mënyrë konstruktive dhe me profesionalizëm procesin e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive